REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4662 Prot. Maliq, më 29.08.2025

VENDIM
Nr.105, datë 26.08.2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBROJTJES SOCIALE I BASHKISË MALIQ 2025–2028 "

Në mbështetje të nenit 24 pika 1, të ligjit nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika nënpika 1.1, gërma "b" nenit 24 *"Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale"* pika 1, nenin 54 *"Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak"*, gërma "k" neni 55 *"Votimi"* pika 2, neni 64 *"Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë"* gërma "c", ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* dhe ligjit 121/2016 *"Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"* pas diskutimit dhe Konsultimit Publik, Këshilli i bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e Mbrojtjes Sociale të Bashkisë Maliq 2025–2028

2. Plani i Mbrojtjes Sociale i Bashkisë Maliq 2025–2028 do të rishikohet dhe përditësohet, sipas nevojës, gjatë zbatimit të tij në vitet në vijim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat e Bashkisë Maliq.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 29.08.2025

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ



Plani i Mbrojtjes Sociale
Bashkia Maliq
2025-2028

Plani i Mbrojtjes Sociale është hartuar nga Bashkia Maliq në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore dhe shoqërisë civile, me mbështetjen teknike të Programit të Kombeve te Bashkuara "Askush Të Mos Mbetet Pas" që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikëqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP.



PËRMBATJA

Hyrje

1. **Misioni, vlerat dhe parimet udhërrëfyese**
2. **Metodologjia e hartimit të Planit të Mbrojtjes Sociale**
3. **Situata socio-ekonomike e Bashkisë Maliq**
   - 3.1 Veçoritë fizike dhe mjedisor
   - 3.2 Të dhëna demografike
   - 3.3 Arsimi dhe sfidat e përfshirjes
   - 3.4 Ekonomia dhe mundësitë e zhvillimit local
   - 3.5 Punësimi dhe papunësia
   - 3.6 Shëndetësia dhe shërbimet bazë
4. **Vlerësimi i kapaciteteve institucionale, njerëzore dhe financiare të Bashkisë Maliq për të ofruar shërbime sociale**
   - 4.1 Shërbimi Social në Bashkinë Maliq
   - 4.2 Struktura e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale
   - 4.3 Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social
   - 4.4 Shërbimet e përkujdesit shoqëror në Bashkinë Maliq
   - 4.5 Burimet njerëzore dhe kapacitetet profesionale
   - 4.6 Burimet financiare për shërbimet sociale
   - 4.7 Shoqatat dhe shërbimet jopublike të përkujdesjes sociale
   - 4.8 Vlerësimi i situatës sociale për një vendimmarrje të informuar
5. **Nevojat për shërbime sociale të grupeve vulnerabël dhe atyre në risk**
   - 5.1 Familjet e varfëra
   - 5.2 Personat me aftësi të kufizuara
   - 5.3 Fëmijët në risk
   - 5.4 Fëmijët me aftësi të kufizuara
   - 5.5 Fëmijët në situatë rruge dhe ata që punojnë
   - 5.6 Dhuna ndaj grave dhe vajzave
   - 5.7 Familjet e pastreha
   - 5.8 Komuniteti Rom dhe Egjiptian
   - 5.9 Të moshuarit në nevojë
6. **Fushat, qëllimet dhe objektivat e Planit të Mbrojtjes Sociale 2025–2028**

   Fusha 1: Qasja në shërbime sociale
   Fusha 2: Parandalimi dhe programet ndërgjegjësuese
   Fusha 3: Burimet njerëzore dhe kapacitetet
   Fusha 4: Informimi dhe bashkëpunimi
7. **Anekset**

   Aneksi 1: Plani i veprimit për shërbimet e kujdesit social në Bashkinë Maliq 2025–2028
   Aneksi 2: Plani i monitorimit dhe vlerësimit
   Aneksi 3: Kostimi dhe hendeku buxhetor
   Aneksi 4: Shporta e shërbimeve shoqërore

“Një Bashki Maliq ku askush nuk mbetet pas – çdo qytetare dhe qytetar ka qasje në shërbime sociale cilësore, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke u integruar plotësisht në jetën shoqërore dhe ekonomike të komunitetit.”



Plani i Mbrojtjes Sociale i Bashkisë Maliq 2025–2028

Kuadri ligjor dhe strategjik

Plani i Mbrojtjes Sociale i Bashkisë Maliq 2025–2028 mbështetet në kuadrin ligjor kombëtar dhe në dokumentet strategjike të miratuara nga qeveria shqiptare në fushën e mbrojtjes sociale, përfshirjes dhe barazisë. Ky plan është gjithashtu në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), e cila është institucioni përgjegjës qendror për çështjet e kujdesit dhe mbrojtjes sociale.

Ligjet bazë:

- Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" – përcakton parimet, standardet dhe kompetencat e pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve sociale.
- Ligji nr. 22/2018 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" – garanton mbrojtjen e të drejtave themelore të fëmijëve.
- Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara" – synon barazinë dhe përfshirjen e PAK.
- Ligji nr. 9669/2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar – parashikon mbrojtjen e viktimave dhe shërbime mbështetëse.
- Ligji nr. 9355/2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar – rregullon skemën e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" – përcakton funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve sociale.

Strategjitë kombëtare kryesore:

- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020–2030.
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030.
- Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026.
- Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025.

Hyrje

Plani i Mbrojtjes Sociale i Bashkisë Maliq për periudhën 2025–2028 është një dokument strategjik që përcakton prioritetet dhe drejtimet kryesore të zhvillimit social në territorin e saj. Ai është një instrument i rëndësishëm i qeverisjes vendore, i ndërtuar mbi parimet e gjithëpërfshirjes, barazisë gjinore dhe respektimit të të drejtave të njeriut, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës për çdo qytetare dhe qytetar.

Dokumenti është në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar, përfshirë Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", si dhe me strategjitë kombëtare për mbrojtjen sociale, të drejtat e fëmijëve, barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale. Kjo siguron që prioritetet vendore të harmonizohen me vizionin kombëtar për zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe solidar.

Hartimi i këtij plani është bërë përmes konsultimeve të gjera me institucionet vendore, shoqërinë civile, grupet e interesit dhe përfaqësues të komuniteteve vulnerabël. Kjo ka bërë të mundur që dokumenti të reflektojë realisht sfidat sociale të territorit, veçanërisht ato që lidhen me varfërinë, papunësinë, migracionin dhe nevojat e larta për mbështetje.

Plani vendos theksin tek shërbimet komunitare dhe ato në familje, duke shmangur institucionalizimin afatgjatë dhe duke afruar kujdesin pranë qytetarëve. Përmes hapjes së qendrave ditore për fëmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, krijimit të çerdheve dhe programeve pas-shkollore, si dhe mbështetjes për familjet më të varfra, synohet ndërtimi i një rrjeti shërbimesh të përshtatura me realitetin rural të Maliqit dhe nevojat e komunitetit.

Gjatë periudhës 2025–2028, plani do të zbatohet përmes katër fushave prioritare të ndërhyrjes:

- **Qasja në shërbime sociale**, për të garantuar shërbime të larmishme, cilësore dhe gjithëpërfshirëse.
- **Programet ndërgjegjësuese**, për parandalimin e problemeve sociale përmes edukimit dhe informimit.
- **Burimet njerëzore dhe kapacitetet**, për të forcuar strukturat vendore dhe për të rritur aftësitë e stafit.
- **Informimi dhe bashkëpunimi**, për të siguruar transparencë, pjesëmarrje qytetare dhe partneritete efektive me aktorë lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Një element i rëndësishëm i planit është edhe realizmi financiar: duke marrë parasysh kufizimet e buxhetit vendor, një pjesë e konsiderueshme e ndërhyrjeve do të mbështeten nga donatorët, grantet qeveritare dhe partneritetet me shoqërinë civile e biznesin.

Në thelb, ky plan është një investim social dhe njerëzor, që synon të mos lërë askënd pas, të forcojë kohezionin shoqëror dhe të ndërtojë një komunitet më të drejtë, më solidar dhe më gjithëpërfshirës në Bashkinë Maliq.

Përmbledhje Ekzekutive

Plani i Mbrojtjes Sociale i Bashkisë Maliq 2025–2028 është dokumenti udhëzues i bashkisë për të garantuar një sistem shërbimesh sociale të qasshme, gjithëpërfshirëse dhe cilësore. Ai është ndërtuar mbi parimet e barazisë, solidaritetit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke u përputhur me legjislacionin kombëtar dhe strategjitë për mbrojtjen sociale, të drejtat e fëmijëve dhe barazinë gjinore.

Procesi i hartimit është mbështetur në konsultime të gjera me institucionet vendore, shoqërinë civile, komunitetet vulnerabël dhe partnerët zhvillimorë, duke reflektuar nevojat reale të territorit dhe duke u bazuar në parimin e bashkëpunimit ndërsektorial.

Sfidat kryesore të identifikuara:

- Vetëm 0.7% e popullsisë përfiton nga shërbimet sociale, ndërkohë që rreth 16% është në nevojë.
- Mungesë shërbimesh ditore dhe komunitare, sidomos për të moshuarit, fëmijët dhe PAK.
- Kapacitete njerëzore dhe burime financiare të kufizuara.
- Nevojë më e madhe për mbështetje të komuniteteve vulnerabël (Rom, Egjiptian, gratë kryefamiljare, fëmijët në risk).

Fushat prioritare të ndërhyrjes:

1. Qasja në shërbime sociale – qendra ditore, shërbime në familje, programe pas-shkollore, mbështetje për familjet në varfëri.
2. Parandalimi dhe ndërgjegjësimi – fushata edukative dhe sensibilizuese për dhunën, bullizmin, prindërimin pozitiv dhe për komunitetet vulnerabël.
3. Burimet njerëzore dhe kapacitetet – forcimi i strukturave vendore, trajnime për stafin social dhe menaxhimin e rasteve.
4. Informim dhe bashkëpunim – transparencë më e madhe për qytetarët, linjë kontakti dhe partneritete me OJF, shkolla, shëndetësi dhe biznesin lokal.

Kosto dhe financimi:

- Totali i planit (2025–2028): ~52 milionë lekë
- Shpërndarja sipas fushave:
  - Shërbimet sociale: ~39.5 mln lekë
  - Ndërgjegjësim: ~5.2 mln lekë
  - Kapacitetet: ~4.4 mln lekë
  - Informim & bashkëpunim: ~2.8 mln lekë
- Vetëm 20–30% e kostove mbulohen nga të ardhurat vendore; pjesa tjetër nga donatorë, Fondi Social dhe partnerë privatë.

Përfitimet e pritshme:

- Rritje e qasjes në shërbime sociale për mbi 500 përfitues të rinj çdo vit.
- Mbështetje më e madhe për familjet e varfra, të moshuarit dhe PAK.
- Fuqizim i grave përmes çerdheve dhe programeve pas-shkollore, duke lehtësuar punësimin.
- Parandalim i problemeve sociale përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit.
- Forcim i bashkëpunimit lokal dhe ndërtim i një rrjeti aktorësh për mbrojtjen sociale.

1. Misioni, vlerat dhe parimet udhërrëfyese

1.1 Misioni

"Një Bashki Maliq ku askush nuk mbetet pas – çdo qytetare dhe qytetar ka qasje në shërbime sociale cilësore, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke u integruar plotësisht në jetën shoqërore dhe ekonomike të komunitetit."

Ky mision lidhet drejtpërdrejt me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe mbështetet në parimet e përfshirjes, partneritetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ai është gjithashtu në harmoni me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), sidomos në fushat e reduktimit të varfërisë, barazisë gjinore, punësimit, uljes së pabarazive dhe forcimit të institucioneve.

1.2 Vlerat

Plani i Mbrojtjes Sociale udhëhiqet nga këto vlera themelore:

- **Banorët janë të parët:** nevojat e qytetarëve dhe qytetareve, veçanërisht të grupeve vulnerabël, janë gjithmonë prioritet.
- **Interesi publik:** ky plan është një çështje me interes publik dhe hartimi i tij përfshiu të gjitha grupet e interesuara.
- **Mundësi të barabarta:** çdo person duhet të ketë qasje të barabartë në shërbimet sociale.
- **Pjesëmarrja qytetare:** përdoruesit dhe ofruesit e shërbimeve përfshihen në hartimin, monitorimin dhe zbatimin e planit.

1.3 Parimet

Hartimi dhe zbatimi i Planit udhëhiqet nga parimet:

- Respektimi dhe garantimi i të drejtave sociale, në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar.
- Pjesëmarrja aktive e grupeve përfituese dhe aktorëve të tjerë në të gjitha fazat e procesit.
- Fuqizimi i individëve dhe komuniteteve në nevojë përmes integrimit social dhe ekonomik.
- Mbështetja e interesit më të mirë të fëmijës dhe respektimi i barazisë gjinore.
- Zbatimi i politikave vendore në përputhje me kompetencat e dhëna nga Ligji për Vetëqeverisjen Vendore dhe Reforma Territoriale.
- Garantimi i aksesit të barabartë në shërbimet sociale për të gjithë.
- Shërbime të orientuara drejt de-institucionalizimit dhe kujdesit në komunitet.
- Sigurimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe kosto-efektive.

2. Metodologjia e hartimit të Planit të Mbrojtjes Sociale

Plani Vendor i Mbrojtjes Sociale 2025–2028 është hartuar mbi një qasje pjesëmarrëse, ndërsektoriale dhe të mbështetur në evidencë, duke kombinuar metoda cilësore dhe sasiore. Ky proces kishte për qëllim që dokumenti të pasqyrojë sa më mirë nevojat reale të banorëve të Bashkisë Maliq dhe mundësitë institucionale e financiare për t'iu përgjigjur atyre.

Metodologjia është ndërtuar në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe praktikat e mira të bashkive të tjera, duke marrë parasysh veçoritë e Maliqit si një bashki rurale, me ekonomi të mbështetur kryesisht në bujqësi, me shkallë të lartë migracioni dhe me mungesë shërbimesh të specializuara.

2.1 Hapat kryesorë të procesit

Procesi i hartimit përfshiu disa faza të ndërlidhura:

- **Konsultime paraprake:** me 12 përfaqësues nga institucione qeveritare dhe joqeveritare, ku u prezantua procesi dhe u mblodhën sugjerime mbi prioritetet sociale.
- **Pyetësorë dhe mbledhje të dhënash:** të shpërndara nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në institucionet vendore dhe rajonale, për të evidentuar shërbimet ekzistuese dhe nevojat e popullsisë.
- **Takimi i dytë konsultues:** me 15 përfaqësues (2 burra dhe 13 gra) nga njësi administrative, arsim, shëndetësi, polici, punësim dhe OJF, të cilët kontribuan me propozime konkrete.
- **Analizë e të dhënave sasiore e cilësore:** për popullsinë, arsimin, shëndetësinë, punësimin dhe grupet vulnerabël, me burime si INSTAT, Regjistri Civil dhe plane sektoriale.
- **Diskutime me ekspertë dhe partnerë:** për të siguruar që prioritetet e planit të ishin të realizueshme dhe të mbështetura në kapacitete reale.

2.2 Fokusimi metodologjik

Metodologjia u mbështet në këto shtylla kryesore:

- Analiza socio-ekonomike e bashkisë për të identifikuar trendet që ndikojnë në kërkesën për shërbime.
- Vlerësimi i kapaciteteve institucionale, financiare dhe njerëzore.
- Identifikimi i nevojave të grupeve vulnerabël përmes konsultimeve dhe analizës së të dhënave.
- Evidentimi i praktikave të mira që mund të përshtaten në nivel lokal.
- Hartimi i një plani veprimi të shoqëruar me kostim, për të garantuar realizueshmëri dhe qëndrueshmëri financiare.

Ky proces siguroi që Plani 2025–2028 të jetë gjithëpërfshirës, realist dhe i orientuar drejt rezultateve, duke reflektuar nevojat e komunitetit dhe angazhimin e aktorëve vendorë për t'u përballur me sfidat sociale të së ardhmes.

3. Situata socio-ekonomike e Bashkisë Maliq

3.1 Veçoritë fizike dhe mjedisore

Bashkia Maliq ndodhet në Qarkun e Korçës dhe përfshin 7 njësi administrative: Maliq, Pojan, Libonik, Vreshtas, Pirg, Gorë dhe Moglicë. Me një sipërfaqe prej 656.34 km², ajo përfshin 1 qytet dhe 80 fshatra, duke e bërë një nga bashkitë më të mëdha rurale në vend.

Zona njihet për bujqësinë intensive në fushën e Maliqit, e cila ka qenë për dekada burimi kryesor i të ardhurave për familjet, si dhe për blegtorinë tradicionale në zonat malore të Gorës dhe Moglicës. Përveç tyre, rajoni ka potenciale të mëdha për turizmin natyror dhe kulturor, falë peizazheve, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore.

Megjithatë, këto potenciale mbeten të pashfrytëzuara plotësisht. Bashkia përballet me probleme të infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, që kufizojnë zhvillimin ekonomik e social. Një sfidë e madhe është migracioni i lartë, sidomos i të rinjve, që sjell tkurrje të forcës punëtore, plakje të popullsisë dhe braktisje të fshatrave malore.

3.2 Të dhëna demografike

Sipas Regjistrit Civil (2023), Bashkia Maliq ka 61,891 banorë dhe rreth 20,255 familje. Popullsia është e përqendruar kryesisht në njësitë më të mëdha si Pojan (16,710), Libonik (13,705) dhe Maliq (7,660). Ndërsa njësitë malore të Gorës dhe Moglicës kanë popullsi të shpërndarë në fshatra të vegjël e të largët, ku shërbimet publike janë më të kufizuara.

Tendencat kryesore demografike:

- Rënie e popullsisë për shkak të emigracionit dhe uljes së lindshmërisë.
- Plakje e popullsisë, që rrit nevojën për shërbime të reja për të moshuarit.
- Shpërndarje e pabarabartë: zonat urbane dhe ato pranë fushës së Maliqit janë më të populluara, ndërsa fshatrat malore boshatisen.
- Feminizimi i migracionit: gjithnjë e më shumë gra dhe vajza emigrojnë, duke lënë pas familje me fëmijë dhe të moshuar në situata vulnerabël.

Këto prirje janë në linjë me sfidat kombëtare të evidentuara edhe në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030.

Nevoja kryesore për politika vendore:

- Mbajtja e të rinjve përmes mundësive për punësim dhe arsim.
- Përshtatja e shërbimeve për popullsinë në plakje.
- Mbështetja e familjeve të prekura nga emigracioni.
- Reduktimi i pabarazive territoriale përmes investimeve në infrastrukturë dhe shërbime bazë.

Tabela 1. Të dhëna për numrin e popullsisë dhe numrin e familjeve sipas njësive administrative

Njësia Administrative	Numri i Popullsisë	Numri i Familjeve	Popullsia sipas gjinisë	
			F	M
Maliq	7660	2740	3823	3837
Libonik	13705	4436	6725	6980
Pojan	16710	5301	8149	8561
Vreshtas	10459	3278	5045	5414
Pirg	10001	3197	4839	5162
Gorë/Moglicë	3356	1303	1614	1742
TOTALI	**61891**	**20255**	**30195**	**31696**

3.3 Arsimi

3.3 Arsimi në Bashkinë Maliq

Arsimi në Bashkinë Maliq përbën një nga shtyllat kryesore për zhvillimin social dhe për integrimin e fëmijëve e të rinjve në shoqëri. Përveç rolit edukativ, shkollat dhe kopshtet në territor shërbejnë edhe si hapësira komunitare, ku fëmijët dhe familjet marrin mbështetje sociale, kujdes psiko-social dhe mundësi për përfshirje në aktivitete kulturore e sportive.

Arsimi parashkollor

Në territorin e bashkisë funksionojnë **46 kopshte publike**, ku gjatë vitit shkollor 2022–2023 janë regjistruar **907 fëmijë**, nga të cilët **454 janë vajza**. Në krahasim me vitin shkollor 2021–2022, kur kishte **989 fëmijë të regjistruar**, vihet re një ulje prej **81 fëmijësh**. Ky trend shpjegohet me uljen e lindshmërisë në nivel vendor dhe emigracionin e lartë të familjeve të reja. Megjithatë, prania e një rrjeti të gjerë kopshtesh në të gjitha njësitë administrative mbetet një avantazh për përfshirjen e hershme të fëmijëve në arsim.

Arsimi 9-vjeçar dhe i mesëm

Në arsimin bazë funksionojnë **23 shkolla 9-vjeçare**, të cilat ndjeken nga **2,892 nxënës** (1,384 vajza dhe 1,584 djem). Arsimi i mesëm i lartë mbulohet nga **7 shkolla gjimnaziale**, me gjithsej **709 nxënës të regjistruar**. Këto institucione luajnë një rol vendimtar për përgatitjen e brezit të ri për tregun e punës dhe për përfshirjen e tyre aktive në komunitet.

Stafi arsimor

Në sistemin arsimor të Bashkisë Maliq janë të punësuar **330 mësues**, por mbështetja me **staf ndihmës** është ende e kufizuar. Aktualisht ka vetëm **7 psikologë** në gjithë territorin, një numër i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat e nxënësve në aspektin emocional dhe social. Po ashtu, mungojnë logopedë dhe punonjës socialë që do të mund të ndihmonin shkollat në trajtimin e rasteve të vështira.

Sfida sociale në arsim

- **Braktisja shkollore** mbetet një problem serioz, sidomos në komunitetet rome dhe egjiptiane. Shkaktarët kryesorë lidhen me vështirësitë ekonomike të familjeve, angazhimin e hershëm të fëmijëve në punë dhe migracionin sezonal.
- **Mungesa e stafit mbështetës** (psikologë, punonjës socialë, logopedë) e kufizon aftësinë e shkollave për të adresuar në mënyrë profesionale problemet e nxënësve.
- **Pabarazitë gjinore** janë të dukshme, ku vajzat në zonat malore shpesh përballen me pengesa në ndjekjen e arsimit të mesëm për shkak të distancave dhe kushteve ekonomike.
- **Infrastruktura e amortizuar** në disa shkolla rurale, përfshirë mungesën e ngrohjes, transportit dhe kushteve të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, përbën një tjetër sfidë për arsim gjithëpërfshirës.
- **Shërbime të pamjaftueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara**, të cilët shpesh mbeten të përjashtuar nga aktivitetet për shkak të mungesës së transportit të dedikuar, mësuesve ndihmës dhe qendrave zhvillimore.

Përfshirja sociale përmes arsimit

Arsimi shihet si një instrument kyç për të thyer rrethin e varfërisë dhe për të forcuar kohezionin social në Bashkinë Maliq. Për këtë arsye, janë ndërmarrë një sërë nismash:

- **Kopshtet dhe shkollat** shërbejnë si qendra komunitare që u ofrojnë fëmijëve dhe familjeve shërbime bazë si ushqim, aktivitete jashtëshkollore dhe mbështetje psiko-sociale.
- **Programe ndërgjegjësimi për prindërit** janë zhvilluar me fokus regjistrimin e hershëm në kopshte dhe vijimin e arsimit të mesëm për fëmijët, sidomos për vajzat.
- Në partneritet me shoqërinë civile dhe organizata ndërkombëtare, janë zbatuar **nisma për përfshirjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane**, përmes bursave, mbështetjes me transport dhe materiale shkollore.
- **Promovimi i barazisë gjinore** është bërë pjesë e politikave vendore, duke nxitur vajzat të ndjekin gjimnazin dhe më tej arsimin profesional.

Në përputhje me **Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030**, arsimi në Maliq trajtohet jo vetëm si një proces edukativ, por edhe si një mjet për **integrim social, mbrojtje të fëmijëve dhe fuqizim ekonomik**.

Niveli Arsimor	Nr. Institucioneve	Nr. Nxënësve/Fëmijëve	Vajza	Djem	Nr. Mësuesve	Nr. Psikologëve
Kopshte Publike	46	907	454	453	79	0
Shkolla 9-vjeçare	23	2,892	1,384	1,508	316	7
Shkolla të Mesme	7	709	381	328	74	7

3.4 Shërbimi Social në Bashkinë Maliq

Gjatë katër viteve të fundit, Bashkia Maliq ka bërë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një **rrjeti shërbimesh sociale gjithëpërfshirëse**, duke adresuar nevojat e grupeve vulnerabël dhe duke u përafruar me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kujdesit shoqëror.

Struktura ekzistuese e shërbimeve sociale

Aktualisht në territor funksionojnë një sërë strukturash të specializuara:

- **Qendra Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara**
  Ofron shërbime edukative, rehabilituese dhe integruese për fëmijët me aftësi të kufizuara. Shërbimet përfshijnë logopedi, aktivitete zhvillimore, mbështetje psiko-sociale dhe punë me prindërit.
- **Dy Qendra Ditore për të Moshuarit** – një në qytetin e Maliqit dhe një tjetër në Libonik.
  Këto qendra janë shndërruar në hapësira komunitare ku të moshuarit marrin shërbime sociale, kujdes shëndetësor bazë, aktivitete kulturore dhe rekreative, si dhe shërbime në familje për ata që nuk mund të frekuentojnë qendrat.
- **Qendra e Emergjencës 72-orëshe për Gratë, Vajzat dhe Fëmijët në Situata të Rrezikut**
  Kjo qendër ofron mbrojtje të menjëhershme, strehim të sigurt, ushqim, shërbime psiko-sociale, asistencë ligjore dhe këshillim për gratë, vajzat dhe fëmijët që ndodhen në situata rreziku, dhune apo rruge. Synimi kryesor është garantimi i sigurisë së menjëhershme dhe referimi në shërbime afatgjata për riintegrimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik.
- **Qendra Pas-shkollore (Afterschool) në qytetin e Maliqit**
  E ngritur në bashkëpunim me **Fondacionin Emanuel** dhe **Këshillin e Qarkut Korçë**, kjo qendër ofron mbështetje akademike, aktivitete sociale, kulturore dhe sportive për fëmijët, duke kontribuar në parandalimin e braktisjes shkollore dhe përmirësimin e performancës arsimore.

Struktura njerëzore dhe institucionale

Përveç shërbimeve të drejtpërdrejta, është forcuar dukshëm edhe struktura e **Drejtoria e Shërbimeve Sociale**, duke ndërtuar kapacitete njerëzore e institucionale:

- Në njësitë administrative me mbi **6,000 banorë** janë vendosur **punonjës socialë**, të cilët merren me menaxhimin e rasteve individuale dhe koordinimin me institucionet përkatëse.
- Në të gjitha njësitë funksionojnë **administratorë shoqërorë**, **koordinatorë vendorë** si dhe **2 Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF)**, të cilët mbulojnë identifikimin, referimin dhe monitorimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.
- Janë ngritur **mekanizma të referimit për dhunën në familje dhe për mbrojtjen e fëmijëve**, duke siguruar një reagim të shpejtë dhe ndërsektorial.
- Janë krijuar **Grupet e Dialogut Social** si forume bashkëpunimi ndërmjet bashkisë, shoqërisë civile, institucioneve shtetërore dhe komunitetit.
- Janë nënshkruar **marrëveshje bashkëpunimi** me organizata të shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë që veprojnë në territor, duke shtuar gamën e shërbimeve dhe mbështetjen për grupet vulnerabël.

Sfidat kryesore

Megjithëse janë bërë përparime të dukshme, mbeten disa sfida strukturore dhe funksionale:

- **Nevojat sociale janë më të mëdha se burimet ekzistuese** – ka kërkesë të lartë për shërbime të specializuara (p.sh. për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbime psiko-sociale në shkolla, shërbime për të moshuarit në zonat rurale).
- **Burimet financiare dhe njerëzore janë ende të kufizuara**, duke e bërë të vështirë ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe në shkallë të gjerë.
- **Pabarazia në shpërndarjen territoriale të shërbimeve** – shumica e shërbimeve janë të përqendruara në zonat urbane, ndërsa njësitë malore dhe periferike mbeten të nën-shërbyera.

- **Infrastruktura e disa qendrave sociale** është e kufizuar dhe kërkon investime për të ofruar kushte më dinjitoze dhe shërbime gjithëpërfshirëse.
- **Mungesa e specialistëve të fushave të ndryshme** (psikologë, logopedë, punonjës socialë me profil të specializuar) kufizon cilësinë e ndërhyrjes.

Drejtimet për të ardhmen

Në këtë kuadër, Bashkia Maliq synon:

- Të **forcojë koordinimin ndërinstitucional**, duke lidhur më ngushtë shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale.
- Të **zgjerojë rrjetin e shërbimeve sociale në zonat rurale dhe malore**, në mënyrë që askush të mos mbetet pa akses për shkak të vendbanimit.
- Të **përmirësojë menaxhimin e rasteve** dhe punën ndërsektoriale, në përputhje me Ligjin për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror.
- Të **rrisë kapacitetet njerëzore dhe financiare**, përmes trajnimeve, buxhetimit social të dedikuar dhe partneriteteve me sektorin privat dhe organizatat joqeveritare.
- Të **investojë në infrastrukturën sociale**, duke garantuar kushte dinjitoze për të gjitha kategoritë në nevojë.

Tabela – Shërbimet Sociale në Bashkinë Maliq

Tipi i qendrës/shërbimit	Grupi përfitues	Shërbimet kryesore	Partnerët
Qendër Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe familjet e tyre	Mbështetje edukative, rehabilituese, logopedi, aktivitete zhvillimore, punë me prindërit	Bashkia Maliq, OJQ lokale
Dy Qendra Ditore për të Moshuarit (Maliq & Libonik)	Të moshuarit	Kujdes ditor, aktivitete sociale e kulturore, shërbime shëndetësore bazë, shërbime në familje	Bashkia Maliq, komuniteti lokal
Qendra Emergjence 72-orëshe për Fëmijët në Situatë Rruge	Fëmijë në rrezik	Strehim i përkohshëm, ushqim, mbështetje psiko-sociale, referim në shërbime afatgjata	Bashkia Maliq, strukturat e mbrojtjes së fëmijëve
Qendra Emergjence për Gratë e Dhunuara	Gra dhe vajza viktima të dhunës (dhe fëmijët e tyre)	Strehim i sigurt, mbështetje psiko-sociale, këshillim ligjor, riintegrim social e ekonomik	Bashkia Maliq, OJQ të specializuara
Qendra Pas-shkollore (Afterschool) – Maliq	Fëmijët dhe të rinjtë	Mbështetje akademike, aktivitete sociale, kulturore, sportive, parandalim i braktisjes shkollore	Bashkia Maliq, Fondacioni Emanuel, Këshilli i Qarkut Korçë
Mekanizmat e Referimit për Dhunën në Familje & Mbrojtjen e Fëmijëve	Gra, fëmijë, familje në rrezik	Identifikim, referim, menaxhim rastesh, ndërhyrje ndërsektoriale	Bashkia Maliq, Policia, Shëndetësia, Arsim, OJQ
Grupet e Dialogut Social	Komuniteti dhe aktorët lokalë	Diskutim, planifikim dhe monitorim i çështjeve sociale	Bashkia Maliq, Shoqëria Civile, Institucione vendore

3.4 Ekonomia

Ekonomia e Bashkisë Maliq mbështetet kryesisht në bujqësi dhe blegtori, duke u bërë burimi kryesor i të ardhurave për mbi 70% të popullsisë. Rreth gjysma e prodhimtarisë bujqësore të Qarkut Korçë sigurohet nga kjo bashki, veçanërisht nga fushat pjellore të Maliqit.

- **Zonat malore** (Moglicë dhe Gorë) mbështeten më shumë në blegtori dhe kultivim për vetëpërdorim, por përballen me mungesë infrastrukture dhe shërbimesh mbështetëse.
- **Bimët mjekësore**, edhe pse pjesë e traditës në njësinë Gorë, kultivohen nga shumë pak fermerë, për shkak të mungesës së tregjeve dhe investimeve.
- **Bletaria** ka potencial të madh zhvillimi – vetëm në zonën e Plasës prodhohen rreth 30 ton mjaltë, pjesë e të cilit eksportohet deri në SHBA.
- **Ujitja** mbetet problematike, pasi vetëm 30% e tokave bujqësore ujiten aktualisht për shkak të amortizimit të baseneve dhe kanaleve.
- **Infrastruktura e ruajtjes së prodhimit** është e kufizuar: nga 7 frigoriferët ekzistues, mbulohet vetëm një e treta e prodhimit.
- **Agro-përpunimi** ka mundësi të mëdha, por kërkon investime për të ulur kostot dhe për të rritur konkurrueshmërinë në treg.

Aspekti social dhe gjinor:
Varësia nga bujqësia sjell pasiguri ekonomike, sidomos për gratë dhe të rinjtë që punojnë pa kontrata dhe pa mbrojtje sociale. Kjo e bën ekonominë lokale të brishtë dhe të ekspozuar ndaj emigracionit. Në këtë kuadër, Bashkia Maliq synon të promovojë diversifikimin ekonomik dhe mbështetjen e grave fermere e sipërmarrëse, në përputhje me objektivat e Planit të Barazisë Gjinore për fuqizimin ekonomik të grave rurale.

3.5 Punësimi dhe Papunësia

Sipas të dhënave vendore, shkalla e papunësisë së regjistruar është 264 persona (128 gra). Megjithatë, kjo shifër nuk pasqyron realitetin, pasi pjesa më e madhe e popullsisë është e angazhuar në bujqësi e blegtori informale.

- Vetëm 196 persona përfitojnë nga ndihma ekonomike, duke treguar mbështetje të kufizuar për familjet në nevojë.
- **Punësimi i të rinjve** mbetet sfidë, për shkak të mungesës së mundësive për aftësim profesional dhe hapësira pune të reja.
- **Gratë** kanë akses të kufizuar në punë të paguara, duke mbetur shpesh në bujqësi informale pa mbrojtje sociale.
- **Sektori privat** është ende i dobët, ndërsa sipërmarrjet sociale dhe format alternative të punësimit nuk janë të zhvilluara.

Aspekti social dhe gjinor:
Punësimi informal dhe mungesa e hapësirave për punë të denjë forcon varësinë nga remitancat dhe ndihma ekonomike, duke prekur më së shumti familjet e komuniteteve rome e egjiptiane dhe ato në zonat malore. Në linjë me Planin e Barazisë Gjinore, Bashkia Maliq synon të fuqizojë punësimin e grave dhe të rinjve përmes kurseve të aftësimit, nxitjes së sipërmarrjes dhe krijimit të rrjeteve të bashkëpunimit me bizneset vendore.

3.6 Shëndetësia

Bashkia Maliq ka 7 qendra shëndetësore që ofrojnë shërbime bazë, por mungojnë specialistë dhe pajisje moderne.

- **Mungesë specialistësh:** gjinekologë, pediatër dhe internistë janë të pranishëm vetëm një herë në javë.
- **Pajisje të amortizuara:** aparatura si radiologjia dhe ekografia nuk funksionojnë sipas standardeve.
- **Fshatrat e thella:** shërbimi mbështetet kryesisht te infermierët, duke lënë boshllëqe në kujdesin cilësor.
- **Siguria:** mungesa e rojeve dhe kamerave cenon cilësinë e shërbimit, sidomos gjatë natës.
- **Fushata ndërgjegjësimi:** zhvillohen rregullisht mbi planifikimin familjar dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme, shpesh në bashkëpunim me OJQ-të.

Aspekti social dhe gjinor:
Shëndetësia është e lidhur ngushtë me përjashtimin social. Plakja e popullsisë shton nevojën për kujdes afatgjatë, ndërsa mungesa e shërbimeve të shëndetit mendor mbetet një problem serioz. Për gratë, kufizimi i shërbimeve gjinekologjike dhe i mundësive për lindje brenda bashkisë përbën pengesë serioze në qasjen e barabartë në kujdes shëndetësor. Në përputhje me Planin e Barazisë Gjinore, Bashkia Maliq do të punojë për të garantuar akses të barabartë në shëndetësi, duke përfshirë gratë dhe grupet vulnerabël në shërbimet parandaluese dhe ato kurative.

4. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale, njerëzore dhe financiare të Bashkisë Maliq për shërbimet sociale

4.1 Shërbimet Sociale ekzistuese në Bashkinë Maliq

Në katër vitet e fundit, Bashkia Maliq ka zgjeruar ndjeshëm gamën e shërbimeve sociale të ofruara për komunitetin. Aktualisht funksionojnë disa struktura të specializuara:

- **Qendra Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara**, që ofron mbështetje edukative, rehabilituese dhe shërbime psiko-sociale;
- **Dy Qendra Ditore për të Moshuarit** (në Maliq dhe Libonik), të shoqëruara edhe me shërbime në familje për këtë grupmoshë;
- **Një Qendër Emergjence 72-orëshe për fëmijët në situatë rruge dhe për gratë e dhunuara**, që siguron strehim të përkohshëm dhe referim, të menjëhershme, këshillim dhe ndihmë ligjore;
- **Një Qendër Pas-shkollore (Afterschool) në Maliq**, që kontribuon në edukimin dhe integrimin social të fëmijëve.

Sfidat:
Pavarësisht zgjerimit, shumica e shërbimeve janë të përqendruara në zonën urbane dhe mbeten të pakapshme për njësitë malore dhe periferike. Financat dhe burimet njerëzore janë të kufizuara, çka sjell mungesë mbulimi për kategori vulnerabël si komunitetet rome e egjiptiane, të moshuarit e vetmuar dhe gratë në zonat e thella.

Perspektiva:
Në të ardhmen, bashkia synon të shtojë forma alternative të kujdesit, si shërbimet në familje dhe shërbimet lëvizëse komunitare, për të rritur aksesin në zonat rurale. Gjithashtu, prioritet mbetet partneriteti me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, për të plotësuar boshllëqet ku mungojnë kapacitetet vendore.

4.2 Struktura e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale

Drejtoria e Shërbimeve Sociale është forcuar me një gamë profesionistësh që mbulojnë fusha të ndryshme. Struktura përfshin: drejtorin, përgjegjësen për shërbimet e kujdesit shoqëror, administratorë shoqërorë në çdo njësi, punonjës socialë, specialistë për mbrojtjen e fëmijëve, specialist për dhunën me bazë gjinore, psikologë, logopedë, edukatorë dhe kujdestarë ndihmës.

Sfidat:
Numri i punonjësve mbetet i kufizuar. Një psikolog apo logoped shpesh mbulon një territor shumë të gjerë, me qindra raste. Edhe administratorët shoqërorë kanë nevojë për trajnime të vazhdueshme për çështje delikate si mbrojtja e fëmijëve dhe dhuna në familje.

Perspektiva:
Rritja graduale e stafit dhe forcimi i trajnimeve profesionale do të mundësojnë shërbime më cilësore. Një tjetër prioritet është zhvillimi i kulturës së punës ndërsektoriale, ku arsimi, shëndetësia, punësimi dhe mbrojtja sociale bashkëveprojnë në mënyrë të integruar.

4.3 Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social

Në njësitë kryesore (Pojan, Libonik, Vreshtas, Pirg) janë vendosur si administratorë shoqërorë, ashtu edhe punonjës socialë. Ndërsa në njësitë më të largëta si Gorë dhe Moglicë, funksionojnë vetëm administratorët shoqërorë. Ky model siguron një prani bazë, por jo gjithmonë një mbulim të plotë, sidomos për rastet komplekse.

Sfidat:
Në zonat malore, administratorët shpesh punojnë vetëm dhe pa mbështetje të specializuar. Kjo e bën të vështirë menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, abuzimit të fëmijëve apo aftësisë së kufizuar. Diferencat urbane–rurale mbeten të dukshme dhe krijojnë pabarazi në aksesin e shërbimeve.

Perspektiva:
Prioritet është përmirësimi i logjistikës (transport, mjete pune, digjitalizim), shtimi i burimeve njerëzore në zonat e largëta dhe fuqizimi i mekanizmave të referimit. Një tjetër hap i rëndësishëm është përfshirja e grupeve vulnerabël në vendimmarrje për përshtatjen e shërbimeve.

4.4 Shërbimet e përkujdesit shoqëror në Bashkinë Maliq

1. Qendra Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Ofrohen shërbime zhvillimore (logopedi, fizioterapi, terapi psiko-sociale), si dhe transport i dedikuar për fëmijët. Nga viti 2025, transporti do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë, duke siguruar qëndrueshmëri pas përfundimit të projekteve të financuara nga partnerët.

2. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për Dhunën dhe GTN për Fëmijët

Funksionon një mekanizëm bashkëpunimi ndërinstitucional me dy shtylla:

- **Mekanizmi i Referimit për Dhunën me Bazë Gjinore dhe në Familje**, që menaxhon rastet në koordinim me policinë, shëndetësinë, arsimin dhe OJF-të.
- **Grupi Teknik Ndërdisiplinar (GTN) për fëmijët**, që trajton rastet e fëmijëve në rrezik duke ndjekur parimin "fëmija në qendër".

Këto struktura garantojnë menaxhim rastesh dhe ndërhyrje të koordinuar, por kanë nevojë për forcim të burimeve njerëzore dhe trajnime të vazhdueshme.

3. Shërbimi në Familje për PAK dhe të Moshuarit në Nevojë

Ky shërbim, i financuar për 3 vite nga Fondi Social, u ofron familjeve kujdes bazë, mbështetje psiko-sociale dhe ndihmë praktike. Është veçanërisht i vlefshëm në zonat malore ku mungon qasja në qendra ditore. Synimi është zgjerimi i këtij modeli në çdo njësi administrative.

4. Qendra e Emergjencës për Viktimat e Dhunës dhe Fëmijët në Rrezik

Kjo qendër ofron strehim të përkohshëm, kujdes bazik, mbështetje psiko-sociale dhe ligjore, si dhe plane riintegrimi. Sfida kryesore është sigurimi i stafit 24-orësh dhe kapacitetet e kufizuara për të përballuar rastet nga zonat rurale.

5. Dy Qendrat Ditore për të Moshuarit

Në Maliq dhe Libonik, të moshuarit marrin ushqim, aktivitete sociale dhe mbështetje shëndetësore bazë. Shërbimet ofrohen në partneritet me Këshillin e Qarkut Korçë, Fondin Social dhe OJF-të. Perspektiva është shtrirja e këtyre shërbimeve në fshatra të tjera përmes shërbimeve lëvizëse ose kujdesit në familje.

6. Qendra Pas-shkollore (Afterschool) në Maliq

Kjo qendër përfshin rreth 20 fëmijë nga qyteti, duke u ofruar ushqim pas shkolle, ndihmë për detyrat, aktivitete sportive e kulturore dhe hapësira socializimi. Është një model i suksesshëm për parandalimin e braktisjes shkollore dhe për përfshirjen e fëmijëve nga familje vulnerabël.

4.5 Përmbledhje dhe të dhëna mbi përfituesit

Në total, Bashkia Maliq ofron **6 shërbime sociale kryesore**, që mbulojnë fëmijët, gratë, të moshuarit dhe PAK. Megjithatë, sipas hartëzimit të shërbimeve nga UNDP (2023), kontrasti midis nevojës dhe mbulimit është i madh:

- **Individë në nevojë për shërbime sociale:** 9,900 persona (16% e popullsisë).
- **Përfitues aktualë të shërbimeve konkrete:** vetëm 65 persona (0.7% e popullsisë).
- **Përfitues të ndihmës monetare (ekonomike, pensione sociale):** 9,389 individë.
- **Individë në situatë kritike sociale dhe ekonomike:** 9,638.

Këto shifra tregojnë se, ndonëse ndihmat monetare mbulojnë një pjesë të madhe të popullsisë, shërbimet reale të përkujdesit shoqëror (qendrat ditore, emergjencat, shërbimi në familje) arrijnë vetëm një pjesë shumë të vogël të popullsisë në nevojë.

Tabela 7. Numri i individëve në situatë socio-ekonomike kritike sipas grupeve

Grupi	Numri
Individë perfitues ne skemen e ndihmes	*5,651*
Fëmijë perfitues ne skemen e ndihmes	*2,921*
Fëmijë më aftësi të kufizuara	109
Të rritur më aftësi të kufizuara	978
Gra në kushte kritike	*467*
Të moshuar	*599*
Romë dhe Egjiptianë	198
Të pastrehë te regjistruar	398

4.6 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale

Bashkia Maliq ka bërë përmirësime të dukshme në ndërtimin e strukturës së shërbimeve sociale, duke vendosur punonjës socialë në njësitë kryesore dhe duke rritur bashkëpunimin ndërinstitucional. Mekanizmat si **Grupi Teknik Ndërsektorial për fëmijët (GTN)** dhe **Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për Dhunën në Familje** tregojnë se bashkia ka ndërmarrë hapa seriozë drejt mbrojtjes së grupeve vulnerabël. Megjithatë, kapacitetet njerëzore dhe logjistike mbeten të kufizuara përballë nevojave të shumta të komunitetit.

Stafi aktual shpesh përballet me mungesë burimesh dhe ngarkesë të madhe pune, gjë që e bën të vështirë mbulimin e të gjithë territorit, sidomos në zonat malore dhe të thella rurale. Po ashtu, punonjësit socialë

kanë nevojë për trajnime të vazhdueshme dhe përditësim me praktikat e reja, në mënyrë që shërbimet të jenë cilësore dhe të përshtatura me standardet ligjore e sociale.

Për të garantuar një shërbim më dinjitoz dhe gjithëpërfshirës, është e nevojshme:

- rritja graduale e numrit të specialistëve (psikologë, punonjës socialë, logopedë);
- sigurimi i mjeteve praktike dhe logjistikës për punën në terren;
- motivimi i stafit përmes mbështetjes financiare dhe profesionale.

Në thelb, **investimi në burimet njerëzore** është çelësi për të ndërtuar një sistem shërbimesh sociale që jo vetëm mbulon nevojat minimale, por u jep fëmijëve, grave, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara mundësinë për të jetuar me më shumë dinjitet dhe përfshirje në jetën komunitare.

4.7 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Maliq

Bashkia Maliq mbështet shërbimet sociale kryesisht përmes **fondeve të buxhetit qendror** (transferta të pakushtëzuara dhe sektoriale), të ardhurave nga burimet e veta vendore dhe fondeve të dedikuara si **Fondi Social**.

Shpenzimet për programet e mbrojtjes dhe kujdesit social kanë qenë të konsiderueshme, por shpërndarja e tyre tregon se **pjesa më e madhe shkon për pagesa monetare** (ndihma ekonomike dhe skemat për aftësinë e kufizuar), ndërsa një shumë më e vogël përdoret për zhvillimin e shërbimeve konkrete sociale në komunitet.

Kjo pasqyron një **sfidë të rëndësishme**: mbështetja financiare është ende më shumë pasive sesa aktive. Pra, shumica e familjeve në nevojë marrin pagesa, por shumë pak prej tyre kanë akses në shërbime që i fuqizojnë dhe i ndihmojnë realisht të integrohen në shoqëri. Për shembull, sipas hartëzimit të UNDP (2023), vetëm **0.7% e popullsisë përfiton shërbime sociale**, ndërkohë që rreth **16% e popullsisë ka nevojë** për mbështetje.

Në këtë kuadër, **Fondi Social** ka një rëndësi strategjike, pasi ka mundësuar hapjen e shërbimeve të reja si:

- qendrat ditore për të moshuarit në Maliq e Libonik,
- shërbimi në familje për personat me aftësi të kufizuara,
- projektet për kujdesin afatgjatë.

Megjithatë, për të qenë të qëndrueshme, këto shërbime duhet të integrohen në **buxhetin vendor** pas përfundimit të mbështetjes nga projektet, duke mos mbetur të varura vetëm nga donatorët.

Dimensioni i barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale

Të dhënat tregojnë se **gratë janë më të prekura nga varfëria dhe papunësia**, ndërsa viktimat e dhunës dhe nënat kryefamiljare kanë nevojë për mbështetje të drejtpërdrejtë me shërbime sociale.

Përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) dhe shërbimeve emergjente për viktimat e dhunës, Bashkia Maliq ka filluar të drejtojë fonde konkrete për këtë problem. Sipas **Planit të Barazisë Gjinore**, investimet në shërbime që lidhen me fuqizimin ekonomik të grave, kujdesin ndaj viktimave të dhunës dhe aksesin e barabartë në shërbime sociale janë thelbësore për të ulur pabarazitë ekzistuese.

Në këtë drejtim, rritja e të ardhurave vendore dhe menaxhimi më efikas i burimeve financiare do të ndihmojnë që Bashkia Maliq të ketë më shumë hapësirë buxhetore për shërbimet sociale gjithëpërfshirëse. Kjo ndikon jo vetëm tek fëmijët, gratë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, por gjithashtu redukton varësinë nga ndihmat ekonomike dhe nxit pjesëmarrjen sociale e ekonomike të qytetarëve.

Perspektiva 2025–2028

Për të përmbushur objektivat sociale, Bashkia Maliq duhet të:

- rrisë gradualisht përqindjen e buxhetit që shkon për shërbime sociale aktive, jo vetëm për pagesa monetare;
- garantojë qëndrueshmëri financiare për shërbimet e hapura nga Fondi Social;
- integrojë objektivat e Planit të Barazisë Gjinore dhe Planit Vendor të Arsimit në buxhetimin vjetor;
- forcojë partneritetet me OJF-të dhe sektorin privat për bashkëfinancim dhe shërbime të reja.

Në këtë mënyrë, **burimet financiare kthehen në një mjet real për barazi, përfshirje dhe zhvillim social të qëndrueshëm.**

Tabela 9. Buxheti i Bashkisë sipas burimit të financimit 000/lekë

BURIMET BUXHETORE								
		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Parashikimi sipas Buxhetit	Parashikimi Pritshëm	iParashikimi	Parashikimi	Parashikimi
A	**Të ardhura nga burimet e veta**	136,950	144,014	300,000	300,000	300,524	300,524	300,524
A.1	**Të ardhura nga taksat lokale**	45,398	49,772	108,485	108,485	91,875	91,875	91,875
A.2	**Të ardhura nga taksat e ndara (grante)**	26,078	29,060	29,150	29,150	29,700	29,700	29,700
A.3	**Të ardhura nga tarifa vendore**	55,538	52,972	151,953	151,953	171,229	171,229	171,229
A.4	**Të ardhurat e tjera**	9,936	12,210	10,412	10,412	7,720	7,720	7,720
B	**Të ardhura nga buxheti qendror**	466,723	475,538	531,930	531,930	609,573	611,955	639,790
B.1	**Transferta e pakushtëzuar**	299,169	309,640	359,341	359,341	400,661	403,043	430,878
B.3	**Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale**	167,554	165,898	172,589	172,589	208,912	208,912	208,912
C	**TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR**	41,690	78,701	42,350	42,350	-	-	-
C.1	**Trashëgimi pa destinacion**							
C.2	**Trashëgimi me destinacion**	41,690	78,701	42,350	42,350			
	Totali i të ardhurave (a+b+c)	645,363	698,253	874,280	874,280	910,097	912,479	940,314

4.8 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesjes sociale në Bashkinë e Maliqit

4.8 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesjes sociale në Bashkinë Maliq

Organizatat e shoqërisë civile (OJF-të) janë aktorë shumë të rëndësishëm në hartimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Përfshirja e tyre në proceset e konsultimit dhe hartimit të strategjive vendore e kombëtare është një faktor pozitiv, pasi sjell perspektiva të reja dhe ndihmon në adresimin e nevojave që shpeshherë mbeten jashtë vëmendjes së institucioneve publike. Në territorin e Bashkisë Maliq numri i organizatave aktive është i kufizuar, por ndikimi i tyre është i ndjeshëm.

Aktualisht, në Maliq ushtrojnë veprimtarinë e tyre disa aktorë jopublikë si **World Vision**, **Fondacioni Kenedi**, si dhe **Kishat Ungjillore të Libonikut dhe Vreshtasit**.

- **World Vision** zbaton programe për mbrojtjen e fëmijëve 3–18 vjeç, me fokus në mirëqenie, arsim, rini, mbrojtje nga dhuna dhe mbështetje për familjet e cenueshme.
- **Kisha Ungjillore Libonik**, me mbështetjen e Fondacionit Kenedi, drejton një qendër ditore që ofron shërbime për 26 fëmijë nga familje në vështirësi ekonomike, duke u siguruar ushqim, mbështetje në mësime dhe aktivitete sociale.
- **Kisha Ungjillore Vreshtas** punon me fëmijë dhe të rinj përmes projekteve që synojnë rritjen e mirëqenies dhe ndërgjegjësimit, si dhe mbështetjen e familjeve më të varfra për përmirësimin e kushteve të banimit.
- **Fondacioni Kenedi** ka zhvilluar projekte sociale në disa zona të Maliqit, duke ndihmuar familje me probleme të thella ekonomike.
- **Dorcas**, për më shumë se 20 vite, ofroi mbështetje me pako ushqimore për familjet në nevojë dhe të moshuarit e vetmuar, por aktualisht projektet e saj janë mbyllur.

Megjithëse këto organizata kanë dhënë kontribute të vlefshme, numri i tyre mbetet i pakët dhe shërbimet që ofrojnë janë të kufizuara në kapacitete, llojshmëri dhe mbulim. Për më tepër, mungesa e marrëveshjeve të formalizuara me Bashkinë Maliq bën që bashkëpunimi të mbetet i fragmentuar. Nga njëra anë, raportohen praktika të suksesshme bashkëpunimi, por nga ana tjetër evidentohen boshllëqe, sidomos në raportimin e rregullt të rezultateve dhe në koordinimin afatgjatë.

Për periudhën **2025–2028**, është e nevojshme që Bashkia Maliq të ndërtojë **mekanizma të qëndrueshëm bashkëpunimi dhe referimi** me OJF-të. Organizatat mund të reagojnë shpesh më shpejt se institucionet publike dhe të ofrojnë shërbime të përshtatura për nevojat lokale. Formalizimi i marrëdhënieve përmes marrëveshjeve dhe planeve të përbashkëta pune do të ndihmojë në rritjen e llogaridhënies dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve.

Në këtë drejtim, **Grupi i Dialogut Social në Bashkinë Maliq**, i ngritur së fundmi, është një hap i parë drejt krijimit të një platforme ku ofruesit publikë dhe jopublikë të shërbimeve sociale, së bashku me përfituesit, mund të bashkëpunojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për të përmirësuar cilësinë dhe qasjen në shërbime.

4.9 Vlerësimi i situatës sociale për një vendimmarrje të informuar

Planifikimi i shërbimeve sociale të reja dhe përmirësimi i atyre ekzistuese kërkon një qasje të bazuar në evidencë dhe në të dhëna të sakta. Për këtë arsye, Bashkia Maliq ka nevojë të zhvillojë një **hartë të vulnerabilitetit** që përfshin informacion të detajuar për grupet në nevojë në çdo fshat dhe njësi administrative.

Kjo hartë duhet të përmbajë të dhëna mbi:

- të moshuarit që jetojnë vetëm;
- fëmijët në rrezik dhe ata nga familje me probleme ekonomike;
- personat me aftësi të kufizuara;
- familjet në varfëri;
- komunitetet e pakicave etnike.

Aktualisht, një pjesë e të dhënave mblidhen nga punonjësit e shërbimeve sociale, në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave, OJF-të, institucionet arsimore dhe shëndetësore. Megjithatë, mungon një sistem i plotë dhe i integruar që të sigurojë një pasqyrë të qartë dhe të unifikuar mbi shkallën e vulnerabilitetit.

Për periudhën **2025–2028**, prioritet do të jetë zhvillimi i këtij sistemi, i cili do të mundësojë që planifikimi i shërbimeve të jetë sa më i orientuar drejt nevojave reale të komunitetit. Një vendimmarrje e informuar, e bazuar në evidencë, do të ndihmojë në përdorimin më efikas të burimeve, në rritjen e transparencës dhe në forcimin e besimit të qytetareve dhe qytetarëve te Bashkia.

5. Nevojat për shërbime sociale të grupeve vulnerabël dhe atyre në risk

Ky kapitull paraqet një pasqyrë të situatës sociale në Bashkinë Maliq, duke evidentuar nevojat kryesore të familjeve dhe individëve që përballen me vështirësi ekonomike dhe sociale. Analiza mbështetet mbi të dhëna statistikore, raportime nga strukturat vendore dhe aktorë të tjerë të përfshirë, si dhe mbi konsultimet me komunitetin.

Qëllimi është që vendimmarrja për periudhën **2025–2028** të mbështetet mbi evidenca dhe të orientohet drejt grupeve më të ndjeshme, duke siguruar shërbime më gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura sipas nevojave reale.

5.1 Familjet e varfëra

Familjet që përfitojnë nga **Ndihma Ekonomike** përbëjnë një nga grupet më të mëdha vulnerabël në territorin e Bashkisë Maliq. Në **dhjetor 2024**, numëroheshin **2,522 familje aplikuese**, nga të cilat **96.6%** përfituan nga programi.

Pjesa dërrmuese e tyre jeton në zonat rurale (**95%**), gjë që tregon për një shpërndarje të pabarabartë të varfërisë mes zonës urbane dhe asaj rurale.

Krahasuar me **dhjetorin 2021**, ku aplikuan **2,350 familje**, shënohet një rritje e ndjeshme e kërkesës për mbështetje ekonomike. Kjo dëshmon për përkeqësimin e kushteve sociale dhe ekonomike në familjet e Maliqit, si rezultat i papunësisë së lartë, emigracionit dhe mungesës së mundësive për vetëpunësim.

Perspektiva: për familjet e varfra, prioritet mbetet jo vetëm ofrimi i ndihmës monetare, por edhe **zhvillimi i shërbimeve aktive** që lidhen me përfshirjen në tregun e punës, aksesin në arsim dhe shëndetësi, si dhe mbështetjen me shërbime sociale që fuqizojnë familjet për të dalë nga varfëria afatgjatë.

Tabela 10. Të dhëna të krahasuara për familjet aplikuese dhe përfituese të NE 2021, 2023

		Dhjetor 2021			Qershor 2023			
Njësia administrative	**Familje aplikuese**	**Familje përfituese**		**Familje aplikuese**	**Familje përfituese**			
		Rural	**Urban**	**% e pranimit**		**Rural**	**Urban**	**% e pranimit**
Bashkia Maliq	2350	2134	136	96.6%	2522	2317	119	96.6%

Nga të dhënat vërehet se përqindja më e lartë e familjeve përfituese është në njësitë administrative Pirg dhe Vreshtas (16%). Kjo tregon se varfëria është më e përqendruar në zonat rurale të thella, ku mungesa e mundësive ekonomike dhe e aksesit në shërbime publike është më e theksuar.

Tabela 11. Familje në skemën e NE krahasuar me familjet sipas Gjendjes Civile (Qershor2024)

Njësia administrative	Familje sipas Gjendjes Civile	Familje me NE	Familje përfituese nga Fondi 6%
Maliq	2740	96	40
Libonik	4436	371	43
Pirg	3197	365	27
Pojan	5301	491	50
Vreshtas	3278	425	12
Gorë	1303	70	14
Moglicë	-	67	8
TOTALI	**20255**	**1885**	**194**

Në bazë të të dhënave shihet se në njësitë administrative të Bashkisë Maliq ka gjithsej **20,255 familje**, por vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre përfiton mbështetje sociale. Vetëm **1,885 familje** (rreth **9% e totalit**) marrin ndihmë ekonomike.

Nga analiza gjinore rezulton se numri i përfituesve është pothuajse i barabartë mes grave dhe burrave, me një dallim të vogël në favor të burrave Kjo tregon se nevojat sociale prekin në mënyrë të ngjashme të dyja gjinitë.

Figura 2. Numri i përfituesve sipas gjinisë



Figura 3. Numri i përfituesve sipas grupmoshës

Grupi më i madh i përfituesve është 18–40 vjeç, çka tregon për sfida të mëdha ekonomike dhe sociale tek popullsia në moshë pune.



Shumica e përfituesve kanë vetëm arsim 8/9-vjeçar çka reflekton lidhjen e fortë mes nivelit të ulët arsimor dhe varfërisë.

5.2 Personat me aftësi të kufizuar

Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një grup të ndjeshëm që kërkon shërbime të personalizuara. Në qershor 2023, në territorin e bashkisë u regjistruan:

- 950 persona me invaliditet pune,
- 99 persona të verbër,
- 70 persona para-tetraplegjikë,
- 903 persona me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.

Shumë prej tyre kanë nevojë për kujdestarë ligjorë apo shërbime asistence.

Tabela 12. Të dhëna për personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative (dhjetor 2024)

Të dhënat tregojnë për një shpërndarje të pabarabartë të PAK nëpër njësi, me numrin më të lartë në Pojan dhe Libonik. Këto të dhëna nënvizojnë nevojën për zhvillimin e shërbimeve të specializuara, përfshirë mbështetje psiko-sociale, shërbime rehabilituese dhe integrim në tregun e punës.

Njësia Administrative	Invalid pune	Të verbër gjithsej	Me kujdestar	Para-Tetraplegjik Gjithsej	Me kujdestar	PAK fizik & mendor Gjithsej	Me kujdestar
Maliq	138	6	2	4	4	105	16
Libonik	253	17	7	15	15	179	21
Pirg	131	16	3	11	11	154	41
Pojan	244	28	9	19	19	231	26
Vreshtas	141	26	13	19	19	161	31
Gorë	24	3	1	1	1	47	8
Moglicë	19	3	2	1	1	26	5
TOTAL	950	99	37	70	70	903	148

5.3 Fëmijët në risk

5.3.1 Fëmijët me aftësi të kufizuara

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në territorin e bashkisë Maliq është 111, nga të cilët 20 i përkasin grupmoshës 0-6 vjeç (18%), 68 i përkasin grupmoshës 6-15 vjeç (61%), dhe 23 i përkasin grumpshës 15-18 vjeç (21%). Tabela 13 paraqet të dhënat të ndara sipas njësive administrative.

Tabela 13. Të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative 2024

Njësia administrative	Sipas grupmoshave			
	Gjithsej	**0-6 vjeç**	**6-15vjeç**	**15-18**
Maliq	11	1	6	4
Libonik	18	7	8	3
Pirg	19	3	14	2
Pojan	33	5	24	4
Vreshtas	24	3	11	10
Gorë	6	1	5	0
Moglicë	0	0	0	0
TOTAL	111	20	68	23

5.3.2 Fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë

Tabela 14 paraqet numrin e fëmijëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Në periudhën janar-dhjetor 2022, janë raportuar 43 raste të fëmijëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, nga të cilët 19 fëmijë janë në nevojë për mbrojtje dhe 24 fëmijë të dhunuar/shfrytëzuar.

Tabela 14: Fëmijë në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror (janar-dhjetor 2024)

Bashkia Maliq	**Viti 2024`**
Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut: (referohuni Nr. të rasteve në total)	**68**
• ***i ulët***	**47**
• ***i mesëm***	**20**
• ***i lartë***	**0**
• ***menjëhershëm***	**1**
Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave (referohuni Nr. të rasteve në total)	**68**
• ***dhunë fizike***	**10**
• ***dhunë seksuale***	**5**
• ***dhunë psikologjike***	**14**
• ***trafikim***	**1**
• ***fëmijë në situatë rruge***	**0**
• ***neglizhim***	**29**
• ***probleme social-ekonomike***	**0**
• ***aftësi e kufizuar***	**1**
• ***mosregjistrim në gjendjen civile***	**5**
• ***fëmijë në konflikt me ligjin***	**2**
• ***dhunë në mjedisin digjital***	**0**
• ***fëmijë të huaj tëpashoqëruar***	**0**
• ***fëmijë pa kujdes prindëror***	**0**
• ***Tjetër***	**1**

5.4 Dhuna ndaj grave

Dhuna me bazë gjinore mbetet një problem i rëndësishëm në territorin e Bashkisë Maliq. Gjatë vitit 2024, u raportuan 38 raste të grave që morën urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje dhe 10 raste me urdhër mbrojtjeje.

Këto të dhëna tregojnë domosdoshmërinë e forcimit të mekanizmave të mbrojtjes, rritjes së kapaciteteve të strukturave vendore dhe sigurimit të shërbimeve mbështetëse për gratë dhe fëmijët viktima të dhunës.

Tabela 15. Të dhëna mbi viktimat e dhunës në familje (totali i vitit 2024)

Karakteristika	Të dhëna të Policisë	Të dhëna të Bashkisë
Urdhër i menjëhershëm mbrojtje	38	38
Urdhër mbrojtje	33	33



Nga grafiku shihet se **34 persona kanë marrë urdhër mbrojtjeje për dhunë në marrëdhënie familjare**. Prej tyre:

- **22 janë gra**
- **12 janë burra**

Kjo do të thotë se **shumica e viktimave janë gra**, por edhe burrat nuk janë të përjashtuar nga dhuna në familje.

Nga ana shoqërore, kjo na tregon disa gjëra:

- **Gratë janë më të prekura** nga dhuna për shkak të pabarazive dhe mentalitetit që shpesh i vendos ato në pozita më të dobëta.
- **Raportimi po rritet**, sepse gjithnjë e më shumë viktima po kërkojnë ndihmë dhe po i besojnë institucioneve për mbrojtje.
- **Edhe burrat përjetojnë dhunë**, kryesisht nga te afermit e tyre ose familjare
- **Dëmet prekin gjithë familjen**, sidomos fëmijët që rriten në një ambient të dhunshëm, dhe më gjerë shoqërinë.

5.5 Familjet e pastreha

Në vitin 2024, 92 familje aplikuan për strehim social, prej të cilave 6 kishin kryefamiljare gra. Një pjesë e konsiderueshme e aplikuesve ishin të moshuar të vetmuar (14 raste).

Tabela 16. Të dhëna mbi familjet e pastreha (2024)

Njësia administrative	Numri i familjeve që kanë aplikuar për strehim social	Nr. familjesh me gra kryefamiljare	Numri i individëve në familjet aplikuese për strehim social	Numri i të moshuarve të vetmuar aplikues për strehim social	Numri i viktimave të dhunës në familje që kanë aplikuar strehim social	Numri i familjeve aplikuese për strehim social që përfitojnë ndihmë ekonomike
Libonik	32	2	87	5	-	9
Maliq	36	4	57	1	-	1
Pirg	15	-	48	4	-	6
Vreshtas	3	-	5	1	-	1
Pojan	6	-	17	3	-	4
TOTAL	**92**	**6**	**214**	**14**	-	**21**

5.6 Komuniteti Rom dhe Egjiptian

Numri i përfituesve të shërbimeve, të cilët i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian është 641, nga të cilët 499 i përkasin komunitetit Egjiptian dhe 142 komunitetit Rom.

5.7 Të moshuarit

Nevoja për shërbime për të moshuarit e vetmuar është në rritje. Tabela më poshtë paraqet të dhëna rreth numrit të moshuarve të vetmuar, të cilët kanë nevojë për shërbime. Konkretisht, gjatë vitit 2023, 230 të moshuar kanë kërkuar shërbime në familje, 175 të moshuar kanë kërkuar shërbime në qendër ditore përkujdesi, dhe 6 të moshuar kanë kërkuar shërbime në qendër rezidenciale. Numri i të moshuarve që jetojnë vetëm dhe përfitojnë ndihmë ekonomike është 59.

Të dhëna mbi të moshuarit në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror (total viti 2023)

Njësia administrative	Numri i të moshuarve që kanë kërkuar shërbime në familje	Numri i të moshuarve që kanë kërkuar shërbime në qendër ditore përkujdesi	Numri i te moshuarve që kanë kërkuar shërbime në qendër rezidenciale	Numri i te moshuarve që jetojnë vetëm dhe përfitojnë ndihmë ekonomike
Maliq	30	30	2	11
Libonik	47	30	3	11
Pirg	32	35	0	8

Pojan	43	30	1	13
Vreshtas	49	30	0	6
Gorë	18	10	0	7
Moglicë	11	10	0	3
TOTAL	**230**	**175**	**6**	**59**

Përmbledhje

Analiza tregon se grupet më të prekura në Bashkinë Maliq janë familjet e varfra, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në risk, gratë viktima të dhunës, familjet e pastreha, komunitetet Rom/Egjiptian dhe të moshuarit e vetmuar.

Prioriteti për periudhën 2025–2028 duhet të jetë zgjerimi i shërbimeve aktive dhe gjithëpërfshirëse, përtej ndihmës monetare, duke fuqizuar individët dhe familjet përmes arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe mbrojtjes sociale.

6. Fushat, Qëllimet dhe Objektivat e Planit të Mbrojtjes Sociale 2025–2028

Ky kapitull përcakton drejtimet kryesore strategjike për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes sociale në Bashkinë Maliq gjatë periudhës 2025–2028. Objektivat dhe aktivitetet janë konceptuar për të adresuar sfidat reale të identifikuara në kapitullin 5, si varfëria, izolimi i të moshuarve, mungesa e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, dhuna ndaj grave, braktisja e shkollës dhe mungesa e mundësive për fëmijët vulnerabël.

FUSHA 1: QASJA NË SHËRBIME SOCIALE

Qëllimi:
Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit, diversitetit dhe cilësisë së tyre, duke u fokusuar tek shërbimet ditore, komunitare dhe ato të integruara në familje. Kjo qasje synon të shmangë institucionalizimin afatgjatë dhe të garantojë që fëmijët, të moshuarit, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara të jetojnë me dinjitet në komunitetin e tyre.

Objektivat dhe aktivitetet kryesore:

- **1.1. Shërbime ditore dhe në familje për grupet vulnerabël**
  Do të hartohet një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave për të identifikuar individët dhe familjet më në risk. Shërbimet do të ofrohen në familje dhe komunitet, përmes ekipeve të kombinuara shëndetësi–shërbime sociale (punonjës socialë, mjekë, psikologë, infermierë).
- **1.2. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç**
  Do të ngrihen qendra ditore dhe shërbime të lëvizshme që ofrojnë mbështetje psiko-sociale, rehabilituese dhe zhvillimore. Një fokus i veçantë do të jetë përgatitja për jetë të pavarur, punësim të asistuar dhe integrim aktiv në komunitet.
- **1.3. Shërbime për të moshuarit në nevojë**
  Do të ngrihen qendra ditore për të moshuarit, si në Maliq dhe Libonik, me zgjerim gradual edhe në njësitë e tjera. Shërbimet do të kombinojnë kujdes shëndetësor bazik, aktivitete sociale, kulturore dhe mbështetje ushqimore. Do të parashikohen edhe shërbime në familje për të moshuarit që jetojnë në zona të thella dhe që nuk mund të lëvizin.
- **1.4. Kujdesi për fëmijët – çerdhe dhe afterschool**
  Do të krijohen shërbime të reja ditore për fëmijët, sidomos në zonat me varfëri dhe papunësi të lartë. Programet pas-shkollore do të kombinojnë mësimin e detyrave me aktivitete sociale, sportive e kulturore.
- **1.5. Mbështetje për familjet e varfra**
  Përveç ndihmës ekonomike, familjet në varfëri do të marrin mbështetje emergjente (paketa ushqimore, higjienike, strehim emergjent), por edhe masa afatgjata për rehabilitim dhe fuqizim ekonomik. Do të zbatohen programe strehimi social, do të rehabilitohen banesa të rrezikshme, dhe familjet do të lidhen me mundësi punësimi e trajnime.

FUSHA 2: PARANDALIMI DHE PROGRAMET NDËRGJEGJËSUESE

Qëllimi:
Parandalimi i problemeve sociale përmes informimit, edukimit dhe mobilizimit të komunitetit, me theks tek të rinjtë, gratë, familjet dhe grupet vulnerabël.

Objektivat dhe aktivitetet kryesore:

- **2.1. Përfshirja e komuniteteve vulnerabël**
  Romët, egjiptianët dhe grupet më të varfra do të përfshihen në programe sensibilizuese për reduktimin e braktisjes shkollore dhe martesave të hershme.
- **2.2. Edukimi i të rinjve dhe komunitetit**
  Në shkolla dhe qendra komunitare do të zhvillohen fushata për dhunën me bazë gjinore, bullizmin, sigurinë online dhe përdorimin e substancave narkotike. Një kalendar vjetor fushatash do të sigurojë vazhdimësi dhe përfshirje aktive.
- **2.3. Fuqizimi i familjes përmes informimit**
  Në çdo NjA do të krijohen grupe për prindërimin pozitiv, në bashkëpunim me shkollat dhe qendrat shëndetësore. Do të organizohen takime për gratë mbi raportimin e dhunës, shpërndarje materialesh informuese dhe këndе informacioni për shërbime sociale.

FUSHA 3: BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET

Qëllimi:
Fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe njerëzore, duke e bërë ofrimin e shërbimeve sociale më profesional, efektiv dhe të qëndrueshëm.

Objektivat dhe aktivitetet kryesore:

- **3.1. Forcimi i strukturave vendore**
  Grupi Teknik Ndërsektorial, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, mekanizmat e barazisë gjinore dhe grupet ndërsektoriale do të fuqizohen për menaxhimin e rasteve. Koordinimi mes arsimit, shëndetësisë, policisë dhe punësimit do të përforcohet.
- **3.2. Rritja e kapaciteteve të stafit social**
  Punonjësit socialë dhe stafet e qendrave do të trajnohen rregullisht për ndryshimet ligjore, përdorimin e Fondit Social, shërbimet në familje, menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe funksionimin e qendrave të emergjencës.
- **3.3. Motivimi i stafit dhe përmirësimi i kushteve të punës**
  Do të vendosen skema stimuluese dhe mbështetje psiko-sociale për punonjësit që merren me rastet më të vështira, në mënyrë që të reduktohet lodhja profesionale dhe të rritet cilësia e shërbimit.

FUSHA 4: INFORMIMI DHE BASHKËPUNIMI

Qëllimi:
Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për shërbimet sociale dhe krijimi i një partneriteti të fortë mes Bashkisë Maliq, OJF-ve, biznesit dhe institucioneve shtetërore.

Objektivat dhe aktivitetet kryesore:

- **4.1. Informimi i qytetarëve**
  Informacioni mbi shërbimet do të publikohet përmes faqes së Bashkisë, rrjeteve sociale, njoftimeve në NjA dhe një numri kontakti për raportim rastesh. Do të publikohet një raport vjetor mbi shërbimet e ofruara, me të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshave.
- **4.2. Bashkëpunimi me aktorët lokalë dhe kombëtarë**
  Bashkia do të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me OJF-të dhe do të krijojë rrjete lokale partnerësh (shkolla, shëndetësi, polici, bizneset). Sektori privat do të përfshihet përmes skemave të përgjegjësisë sociale të biznesit (CSR).
- **4.3. Shërbime të integruara ndërsektoriale**
  Do të forcohet bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik, Zyrën e Punësimit dhe institucionet arsimore për ofrimin e shërbimeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse.

Aneksi 1. Plani i Veprimit për shërbimet e kujdesit social në Bashkinë Maliq (2025–2028)

Fusha /Objektivi Qëllimi	Aktivitetet Kryesore	Afati	Treguesit Kryesorë	Përgjegjës	Kosto (000 lekë)
FUSHA 1: Qasja në shërbime sociale	1.1 Shërbime ditore & në familje për të moshuarit, PAK dhe shëndetin mendor	Vlerësim nevojash në 7 NjA; shërbime në familje (social + infermier); 2 trajnime/vit; fushata ndërgjegjësimi	2025–2027	1 raport; 100 familje/vit; 20 profesionistë trajnuar/vit	DShS, NjA, QS	2,500
	1.2 Shërbime ditore për PAK mbi 18 vjeç	Adaptim i një hapësire ditore; ekip multidisiplinar; fushata ndërgjegjësimi	2026–2027	1 qendër ditore (2026); 30 PAK përfitues; 2 fushata deri 2027	DShS, NjA, OJF	8,000
	1.3 Qendra ditore për të moshuarit	Adaptim godine ekzistuese; shërbime ditore; shtrirje në 2 NjA (Libonik & Pojan); fushata	2026–2028	2 qendra funksionale; 100 të moshuar/vit; 2 fushata/vit	DShS, NjA, OJF	12,000
	1.4 Shërbime për fëmijë (çerdhe & after-school)	Adaptim i 1 çerdheje; 2 programe pas-shkollore rurale; trajnime edukatorësh; sensibilizim prindërish	2025–2028	1 çerdhe + 1 after-school; 150 fëmijë/vit; 50 gra të mbështetura në punësim	DShS, Drejtoria e Arsimit, NjA	10,000
	1.5 Mbështetje për familjet e varfra	Paketa ushqimore & higjienike (150 familje/vit); partneritete me 10 biznese; rehabilitim 20 banesash; lidhje me punësim	2025–2028	150 familje/vit; 10 biznese partnere; 20 banesa të rehabilituara	DShS, NjA, Bizneset, OJF	7,000
FUSHA 2: Parandalimi dhe ndërgjegjësimi	2.1 Ndërgjegjësimi i të rinjve & komunitetit	Fushata në shkolla & komunitet; kalendar vjetor; klube rinore; rrjete sociale	2025–2028	≥4 fushata/vit; ≥3 klube rinore funksionale	DShS, shkolla, OJF	600/vit (≈2,400)
	2.2 Fuqizimi i familjes	Grupe prindërimi; takime për gratë; materiale informuese; këndе info në shkolla/shëndetësi	2025–2028	≥7 grupe prindërimi; ≥2 takime/NjA; ≥500 familje të mbuluara	DShS, NjA, QS	400/vit (≈1,600)
	2.3 Përfshirja e komuniteteve vulnerabël	Fushata për Rom/Egjiptianë; rrjete solidariteti lokal	2025–2028	≥3 fushata; ≥2 rrjete solidariteti	DShS, OJF, NjA	300/vit (≈1,200)
FUSHA 3: Burime njerëzore & kapacitete	3.1 Forcimi i strukturave vendore	Aktivizim GTN; trajnime ndërinstitucionale; mbështetje stafit emergjence	2025–2028	GTN funksional; ≥2 trajnime/vit; stafe emergjence të mbështetur	DShS, GTN, NjA	500/vit (≈2,000)
	3.2 Trajnime për stafin social	Sesione ligjore; NJMF; Fondi Social; qendrat ditore/rezidenciale	2025–2028	≥4 trajnime/vit; ≥50 punonjës trajnuar	DShS, qendrat sociale	600/vit (≈2,400)
FUSHA 4:	4.1 Informim i	Rrjete sociale, faqe	2025–	1 raport/vit; ≥500	DShS, NjA	300/vit

Informim & bashkëpunim	qytetarëve	bashkie, numër kontakti, raport vjetor mbi shërbimet	2028	qytetarë informuar/vit		(≈1,200)
	4.2 Bashkëpunim me aktorët	Marrëveshje me OJF; rrjet partnerësh (shkolla, polici, biznes); bashkëpunim me DRShP & ZRP	2025–2028	≥5 marrëveshje; ≥1 rrjet funksional	DShS, NjA, OJF, DRShP, bizneset	400/vit (≈1,600)

Aneksi 2. Plani i monitorimit dhe vlerësimit

Plani i Mbrojtjes Sociale i Bashkisë Maliq për periudhën 2025–2028 është një dokument orientues, i cili synon t'i japë zgjidhje sfidave sociale përmes shërbimeve të aksesueshme, programeve parandaluese dhe mbështetjes së grupeve më vulnerabël. Për ta bërë këtë plan të zbatueshëm, monitorimi dhe vlerësimi do të jenë mekanizmat kryesorë për të matur progresin dhe për të bërë rregullimet e nevojshme gjatë rrugës.

Struktura përgjegjëse

- **Drejtoria e Shërbimeve Sociale (DShS)** është institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin. Ajo do të mbledhë të dhëna nga njësitë administrative dhe qendrat e shërbimit, do të koordinojë bashkëpunimin me OJF-të dhe do të përgatisë raportet vjetore.
- **Njësitë Administrative (NjA)** do të kenë rol të rëndësishëm, pasi ato janë më afër komunitetit dhe mbledhin informacionin mbi përfituesit dhe nevojat konkrete.
- **Këshilli Bashkiak** do të shqyrtojë raportet vjetore dhe do të japë rekomandime për përmirësime.
- **Përfaqësues të komuniteteve vulnerabël** (gra, persona me aftësi të kufizuara, romë/egjiptianë) do të ftohen të marrin pjesë në takimet vjetore të monitorimit, për të siguruar që përvoja e tyre të reflektohet në raportim.

Procesi i monitorimit

Monitorimi do të fokusohet tek:

1. **Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara** – sa shërbime janë ngritur, sa fushata janë zhvilluar, sa familje janë mbështetur etj.
2. **Cilësia e shërbimeve** – duke përdorur feedback nga qytetarët dhe përfituesit.
3. **Përdorimi i burimeve** – raportim mbi buxhetin e përdorur dhe mbështetjen e marrë nga donatorë apo partnerë.
4. **Ndikimi social** – matja e rezultateve afatgjata, si p.sh. ulja e numrit të rasteve të dhunës, rritja e përfshirjes së grave në tregun e punës, apo përmirësimi i aksesit të personave me aftësi të kufizuara në shërbime.

Cikli i monitorimit dhe vlerësimit

- **Raportimi vjetor:** Çdo vit Drejtoria e Shërbimeve Sociale do të përgatisë një raport mbi progresin e arritur dhe sfidat e hasura. Ky raport do të paraqitet në Këshillin Bashkiak dhe do të publikohet për qytetarët.
- **Vlerësim i mesëm (2026):** Do të bëhet një analizë e thelluar e arritjeve dhe vështirësive, duke rishikuar aktivitete ose objektiva që nuk janë realizuar sipas planit.
- **Vlerësim përfundimtar (2028):** Do të vlerësohet ndikimi i planit në komunitet, rezultatet e arritura dhe çështjet që duhet të adresohen në planin pasardhës.
- Do të përdoret një **kalendar i detajuar monitorimi (2025–2028)**, ku përcaktohen periudhat e raportimit, vlerësimit të mesëm dhe atij përfundimtar, për të lehtësuar planifikimin e stafit bashkiak.

Përmirësimi i sistemit të të dhënave

Për monitorim efektiv, do të përdoren formate standarde raportimi për njësitë administrative dhe qendrat ditore. Të dhënat do të përfshijnë indikatorë bazë si:

- Numri i përfituesve sipas gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar.
- Numri i shërbimeve të reja të hapura dhe i programeve të zbatuara.
- Shkalla e pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese.
- Raportimet e rasteve të dhunës apo të emergjencave sociale.

Roli i partnerëve

- **Shoqëria civile** do të kontribuojë me shërbime shtesë dhe me monitorim të pavarur të planit.
- **Komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët** do të mbështesin financiarisht disa ndërhyrje, sidomos në fushën e shërbimeve ditore për fëmijë dhe personat me aftësi të kufizuara.
- **Bizneset vendore** do të përfshihen përmes programeve të përgjegjësisë sociale (CSR), duke kontribuar me mbështetje materiale, punësim apo sponsorizime.

Konsultimi dhe transparenca

- Rezultatet e monitorimit do të bëhen publike çdo vit përmes faqes së internetit të bashkisë, rrjeteve sociale dhe njoftimeve në njësitë administrative.
- Do të organizohen takime konsultuese me komunitetin dhe OJF-të për të diskutuar progresin dhe për të marrë sugjerime konkrete.
- Përveç publikimit online, rezultatet do të shpërndahen edhe në formë të thjeshtëzuar (broshura, fletë informuese) në njësitë administrative, për të garantuar transparencë dhe qasje më të gjerë.

Përparësitë e kësaj qasjeje

- Siguron që plani të jetë i zbatueshëm në praktikë, jo vetëm në letër.
- Rrit llogaridhënien e bashkisë përballë qytetarëve.
- Ndihmon në përdorimin më efikas të burimeve financiare dhe njerëzore.
- Forcon bashkëpunimin ndërmjet aktorëve lokalë dhe kombëtarë.

Kalendar vizual i monitorimit (2025–2028)

Viti	Aktivitetet kryesore monitoruese
2025	Raport vjetor i parë, nisja e matjes së indikatorëve
2026	Raport vjetor + vlerësim i mesëm, rishikim objektivash
2027	Raport vjetor, përshtatje e aktiviteteve sipas rezultateve
2028	Raport final dhe vlerësim përfundimtar

Aneksi 3. Kostimi dhe hendeku buxhetor

Plani i Mbrojtjes Sociale i Bashkisë Maliq (2025–2028) është ndërtuar mbi parimin e buxhetimit me bazë programi: së pari përcaktohen fushat dhe objektivat strategjikë, më pas përllogariten kostot për t'i bërë ato të realizueshme. Kjo qasje lejon që planifikimi financiar të lidhet ngushtë me nevojat reale të qytetarëve dhe me prioritetet sociale të bashkisë.

Duke qenë se të ardhurat e veta janë të kufizuara, Bashkia Maliq nuk mund të mbulojë e vetme kostot e larta që kërkon ngritja dhe funksionimi i shërbimeve sociale. Për këtë arsye, një pjesë e konsiderueshme e fondeve do të kërkohet nga burime të jashtme – përmes partneriteteve me donatorë, organizata joqeveritare dhe fonde të qeverisë qendrore (Fondi Social, programet IPA dhe projekte të organizatave ndërkombëtare).

Përmbledhja e kostove sipas fushave (2025–2028)

Nr.	Fusha e veprimit	Totali kostos (lekë)	iFinancuar nga Bashkia	%	Donatorë OJF Grante qeveritare	/% /
1	Qasja në shërbime sociale (qendrat ditore, shërbimet në familje, çerdhe & after-school, rehabilitim banesash, paketa ushqimore)	39,500,000	8,000,000	20%	31,500,000	80%
2	Programe ndërgjegjësuese (fushata në shkolla & komunitet, prindërim pozitiv, sensibilizim për komunitete vulnerabël)	5,200,000	1,000,000	20%	4,200,000	80%
3	Burime njerëzore dhe kapacitete (trajnime për stafin, forcim i NJMF & GTN, mbështetje për qendrat sociale)	4,400,000	900,000	20%	3,500,000	80%
4	Informim dhe bashkëpunim (rrjete bashkëpunimi, publikim raportesh, numër kontakti, marrëveshje me OJF)	2,800,000	800,000	30%	2,000,000	70%
Totali		**51,900,000**	**10,700,000**		**41,200,000**	

Analizë dhe përfundime

1. **Fusha 1 – Qasja në shërbime sociale** ka koston më të lartë (39.5 milionë lekë, rreth 76% e totalit). Kjo është e kuptueshme, pasi këto shërbime ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve: qendra ditore për fëmijë dhe të moshuar, shërbime në familje, çerdhe dhe programe pas-shkollore, si dhe rehabilitim banesash. Investimet janë parashikuar kryesisht në vitet 2026–2028, për t'i dhënë kohë bashkisë të sigurojë bashkëfinancim nga Fondi Social dhe partnerët.
2. **Fusha 2 – Programet ndërgjegjësuese** ka një kosto më të moderuar (5.2 milionë lekë). Këto aktivitete kanë ndikim të gjerë me shpenzime të ulëta: fushata në shkolla e komunitet, sensibilizim për prindërimin pozitiv dhe angazhimin e komuniteteve vulnerabël.
3. **Fusha 3 – Burimet njerëzore dhe kapacitetet** kërkon 4.4 milionë lekë. Kjo përfshin trajnimin dhe fuqizimin e stafit social, forcimin e strukturave vendore (NJMF, GTN, NjA)

dhe mbështetjen e qendrave ekzistuese. Investimet do të shpërndahen gradualisht gjatë gjithë periudhës, për të siguruar profesionalizëm dhe qëndrueshmëri.

4. **Fusha 4 – Informim dhe bashkëpunim** ka koston më të ulët (2.8 milionë lekë). Megjithatë, ndikimi i saj është i rëndësishëm, pasi lidhet me transparencën, komunikimin me qytetarët dhe forcimin e partneriteteve me OJF-të dhe biznesin lokal.
5. **Hendeku buxhetor** është i dukshëm: nga totali prej rreth 52 milionë lekësh, Bashkia Maliq mund të mbulojë vetëm 10.7 milionë (≈20%). Kjo do të thotë se mbi 41 milionë lekë duhen siguruar nga burime të jashtme.
6. **Për të mbuluar këtë hendek,** Bashkia Maliq duhet të:
    - përgatisë projekte konkrete për qendrat ditore dhe shërbimet në familje, për aplikim në Fondin Social të MSHMS dhe fondet IPA;
    - forcojë partneritetet e qëndrueshme me OJF-të që tashmë operojnë në territor (World Vision, Kenedi Foundation, Dorcas, etj.);
    - nxisë përfshirjen e biznesit lokal përmes mekanizmave të përgjegjësisë sociale (CSR).

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 29.08.2025

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLI SHI

